



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 27.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 26.02.2019 të parashtruar nga grupi i Operatoreve Ekonomik "TECH VISION" për aktivitetin :"**Furnizimi me tripod projektora dhe drona**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-8625-121 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "Tech Vision" e datës 26.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Furnizimi me tripod projektora dhe drona**", me Nr.616 18 8625 121 Nr. Brendshëm 616 18 124 121 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së dhe Refuzimin e tenderit të pretenduesit ,të 11.01.2019,dërguar me datën 22.02.2019 dhe publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Vërtetohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 22.02.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Opratori Ekonomik "TECHVISION" me datë 26.02.2019 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"**Furnizimi me tripod projektora dhe drona**". Autoriteti Kontraktues, me datë 27.02.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës.Pretendimi i tij ka të bëjë me kerkesën për sqarime që AK-ja i ka kërkuar nga tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës lidhur me skadimin e afatit të çertifikatave të dorëzuara.Lidhur me këlë pretendim i sqarojmë ankesit se AK-ja ka kërkuar sqarime sipas nenit 72 të LPP-ik,pasiqë çertifikatat e dorëzuara nga i njejt

kanë qenë me afat të skaduar. Poashtu bazuar në nenin e njejtë dhe duke respektuar trajtimin e barabartë të tenderuesëve është kërkuar sqarim lidhur me çertifikata edhe nga dy tenderuesit tjerë (ankuesi është njeri nga ata) edhe pse nuk kanë dorëzuar çertifikata fare në tenderët e tyre. Tenderuesi i propozuar dhe tenderuesi ankues kanë dorëzuar çertifikata e njejta që d.t.th.të të njejtit prodhues dhe bazuar në këtë AK-ja ka propozuar për dhënje të kontratës OE-ik që ka ofruar çmimin më të ulët që ka qenë kriteri i dhënjes.

Bazuar në faktin se Autoriteti Kontraktues ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë tenderuesit dhe se ka propozuar për dhënje të kontratës tenderusin me çmimin më të ulët e që d.t.t.h.se ka respektuar kriterin e cekur në FDT, konstatohet se kërkesa e parashtruar është e pa bazuar.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit